

The image features a central white smartphone screen on a blue background. The screen displays a social media post with a profile picture of a young man, a text input field, and a thumbs-up icon. The background is filled with various social media icons including hearts, thumbs-up, YouTube, Snapchat, WhatsApp, Instagram, Facebook, and Twitter. There are also several yellow smiley face emojis scattered around the screen. The text is centered on a blue rectangular area within the screen.

UDHËZUES I  
DETAJUAR PËR FËMIJË  
PËR RRJETET  
SOCIALE





**Autorët**

Teuta Zymeri

Liridon Latifi

Anil Gashi

nga Qendra për studime të avancuara FIT

**Lektor:**

Envinion

**Dizajni, faqosja dhe shtypja:**

Envinion

**Mbështetur nga:**

**BRICK2**

BRICK2 është program i themeluar dhe implementuar nga CDF në partneritet me Qendrën për studime të avancuara FIT



# PËRMBAJTJA

<b>Hyrja</b>	<b>5</b>
<b>Facebook</b>	<b>5</b>
• Parametrat e Privatësisë	6
• Kohështrirja dhe etiketimet	6
• Vendndodhja	7
• Aplikacionet e faqeve në internet	8
<b>Instagram</b>	<b>9</b>
• Rregullimi i privatësisë	9
• Si të raportoni përmbajtjet e papërshtatshme?	10
• Si të bllokoni dikë që ju bezdisë?	11
• Si të eksploroni instagramin?	11
• Si të jeni më të sigurt në instagram?	11
<b>Snapchat</b>	<b>12</b>
• Sigurohuni që vetëm shokët tuaj të mund të ju kontaktojnë	12
• Sigurohuni që vetëm miqtë tuaj të mund të shohin storjet tua	12
• Largojeni profilin tuaj nga seksioni “Shto Shpejtë” (ang. Quick Add).	13
• Kushtojini vëmendje “Screenshot-ëve”	13
• Mos merrni parasysh (ang. Ignore) ose bllokoni profilet e panjohura që ju dërgojnë kërkesa për miqësi	14
• Mos e ndani emrin e profilit tuaj të Snapchat në rrjetet tjera sociale apo në forume online	14

## Hyrje


Për shumicën e fëmijëve Kosovarë përdorimi i rrjeteve sociale është përditshmëri dhe pjesë aktive e jetës së tyre. Tek të rinjtë Kosovar, përdorim më të gjerë kanë rrjetet sociale Facebook, Instagram, dhe Snapchat. Përpos benefiteve që rrjetet sociale sjellin në jetët tona, ato sjellin edhe rreziqe të ndryshme. Në këtë udhëzues, fëmijët mund të mësojnë se si të rregullojnë parametrat e privatësisë në tri rrjetet sociale: facebook, instagram dhe snapchat. Moshë e lejuar për të pasur llogari në këto rrjete sociale është mbi 13 vjeç.

# FACEBOOK

## Parametrat e Privatësisë

Për të rregulluar parametrat e privatësisë, ju fillimisht duhet të klikoni tek butoni i rumbullaksuar mëposhtë, dhe pasi të hapen rubrikat, ju duhet të vazhdoni duke klikuar tek opsioni "parametrat".


Figura 1. Parametrat



Pasi të keni përzgjedhur opsionin "parametrat", në ekranin tuaj do të shfaqen disa opsione, ju fillimisht duhet të vazhdoni tek "privatësia" (Figura.2.).

**VËREJTJE:** Rrjeti social Facebook ofron shërbimet e tij në disa gjuhë, duke përfshirë edhe gjuhën shqipe. Sidoqoftë, edhe nëse ju zgjedhni gjuhën shqipe si gjuhë primare në këtë rrjet social, për shkak të përditësimeve të opsioneve të ndryshme disa nga opsionet do të dalin ende në gjuhë angleze. Për këtë shkak, në këtë udhëzues disa nga opsionet do të jenë në gjuhë angleze në figura, sidoqoftë, brenda tekstit ato do ti gjeni në gjuhë shqipe dhe poashtu me perktim në gjuhë angleze

Figura 2. Privatësia



Si hap i parë, tek "Rregullat e privatësisë dhe veglat" në pjesën "Aktiviteti yt" ju duhet të siguroheni se tek opsioni "Kush mund t'i shikojë postimet tuaja të ardhshme?" të keni zgjedhur opsionin vetëm "Shokët". Më tutje, tek opsionet "Si të gjejnë dhe kontaktojnë me ty të tjerët" ju duhet të siguroheni që kërkesa për shoqërim mund të ju dërgojnë vetëm "shokët e shokëve" duke evituar mundësinë që përdoruesit me të cilët ju nuk keni miq të përbashkët të mund të ju dërgojnë kërkesë për miqësi dhe në këtë mënyrë ju rrisni sigurinë tuaj në Facebook. Tek opsioni "Dëshironi që motorët e kërkimit jashtë Facebookut të lidhen me profilin tuaj?" (ang. "Do you want search engines outside of Facebook to link to your profile?") ju duhet të zgjedhni opsionin "Jo", sepse kjo eviton rastet kur dikush ju kërkon në platformat e kërkimit sikur "Google" dhe profili juaj i Facebookut të mos shfaqet në motorët e kërkimit.



## Kohështrirja dhe etiketimet

Vazhdoni tek “Rregullimet e kohështrirjes dhe të etiketimeve”. Sigurohuni që tek “Kohështrirja” në dy opsionet “Kush mund të postojë në Kohështrirjen tënde?” dhe “Kush mund të shikojë se çka postojnë të tjerët në kohështrirjen tuaj” të zgjedhni opsionin “Shokët”. Më tutje, vazhdoni tek pjesa “Etiketimi” dhe sigurohuni që keni zgjedhur opsionin “Shokët” tek “Kush mund të shikoj postimet në të cilat ju jeni etiketuar” (ang. “Who can see posts you’re tagged in your timeline?”).

Si hap i fundit tek “Kohështrirja dhe etiketimet”, ju duhet që të siguroheni që tek pjesa “Rishikimi” të keni zgjedhur opsionin

“Aktiv” për opsionet “Rishikoni postimet në të cilat jeni etiketuar para se ato të shfaqen në kohështrirjen tuaj?” (ang. “Review posts you’re tagged in before the post appears on your timeline?”) dhe “Rishikoni se në çfarë jeni etiketuar nga të tjerët para se ato të shfaqen në Facebook?” (ang. Review tags people add to your posts before the tags appear on Facebook?). Duke ndërmarrur këto hapa, ju evitoni rastet në të cilat ju mund të etiketoheni në postime të ndryshme të cilat ju nuk i shihni të përshtatshme të jenë në kohështrirjen tuaj.

Figura 3. Kohështrirja dhe etiketimet


Rregullimet e kohështrirjes dhe të etiketimeve			
Kohështrirja	Kush mund të postojë në Kohështrirjen tënde?	Shokët	Redakto
	Kush mund të shikojë se çka postojnë të tjerët në kohështrirjen tuaj?	Shokët	Redakto
Etiketimi	Who can see posts you’re tagged in on your timeline?	Shokët	Redakto
	When you’re tagged in a post, who do you want to add to the audience of the post if they can’t already see it?	Vetëm unë	Redakto
	Kush mund t’i shikojë sugjerimet për etiketa kur ngarkohen foto që të ngjajnë ty?	Askush	Redakto
Rishikimi	Review posts you’re tagged in before the post appears on your timeline?	Aktiv	Redakto
	Bëni një shikim paraprak se si e shohin njerëzit tjerë kohështrirjen tuaj		Shiko si
	Review tags people add to your posts before the tags appear on Facebook?	Aktiv	Redakto

## Vendndodhja

Gjatë përdorimit të Facebook, rekomandohet që të mos shpërndani informacione për vendndodhjen tuaj. Këtë gjë mund ta bëni duke mos bërë "check-in" dhe duke rregulluar opsionin "Vendndodhja" tek parametrat e privatësisë. Parametri "vendndodhja" duhet të rregullohet kur ju qaseni në Facebook përmes telefonit. Kjo bëhet duke ndjekur tre hapa që shihen në figurën e mëposhtme.

Hapi i parë është që të zgjedhni opsionin "vendndodhja", duke vazhduar tek opsioni i dytë "Lejoni Facebookun të ketë qasje" në të cilin ju prap zgjedhni opsionin "vendndodhja" (ang. "location"), dhe pastaj zgjedhni opsionin "Asnjëherë" (ang. "never"). Duke ndërmarrur këto hapa, ju siguroheni se vendndodhja juaj të mos jetë e qasshme nga të tjerët.

Figura 4. Vendndodhja






## Aplikacionet e faqeve në internet


Shpeshherë ndodh që kur të instaloni aplikacione te ndryshme në telefonin tuaj, si p.sh. "9GAG", "CandryCrush", "FarmVille", "Booking" etj. të ju kërkohet që të ndani disa të dhëna personale. Shumica e këtyre aplikacioneve poashtu ofrojnë mundësinë që ju të lidhni llogarinë tuaj në Facebook me këto aplikacione, dhe në këtë mënyrë ju lejoni që ky aplikacion specifik të ketë qasje në të dhëna tuaja personale. Rekomandohet që ju të ndani vetëm të dhënat bazë të cilat kërkohen, kurse ato shtesë të cilat janë opsionale ti mbani private. Më tutje, rekomandohet që të gjitha aplikacionet që nuk i përdorni më, ti shkyçni nga Facebooku. Për të parë se cilat janë aplikacionet e faqet në internet në të cilat ju jeni të lidhur përmes Facebookut, ju duhet që si nëfigurën e mëposhtme të shkoni tek "Aplikacionet e faqet në internet", dhe të zgjedhni opsionin "Aktive".

Figura 5. Aplikacionet e faqeve në internet



Për të parë se cilat informacione ju i ndani me këto aplikacione, mjafton që të klikoni tek aplikacioni, në këtë rast nese me tastin e majtë zgjedhim "TripAdvisor", do të hapet faqja si nëfigurën 6. në të cilën informacionet të rrethuara me të kuqe, në këtë rast "Emri, Mbiemri, Fotografia e Profilit, Moshë, Gjinia dhe informacionet tjera publike" janë të detyrueshme. Kurse informacionet të rrethuara me ngjyrë të kaltërt si "Lista e Shokëve" dhe "Kush mund të shohë që ju e përdorni këtë program" janë të dhëna të cilat ju mund të mos i ndani. Rekomandohet që të rishikoni të gjitha aplikacionet të cilat janë të lidhura me llogarinë tuaj të Facebookut, dhe nëse ka aplikacione të cilat më nuk i përdorni, atëherë vetëm klikoni me tastin e majtë në atë aplikacion, dhe prekni butonin "Hiq" i cili është i rrethuar në figurën 5.

Figura 6. Editimi i informacioneve në aplikacionet aktive








# INSTAGRAM

Instagrami është një rrjet social shumë i popullarizuar që përdoret për shpërndarjen e fotografive dhe videove. Instagrami poashtu ofron mundësi për komunikim (chat). Shpërndarja e fotografive dhe videove posaçërisht është shumë atraktive për fëmijët ngaqë mundëson rregullimin e fotografive me filterë të ndryshëm. Videot mund të jenë nga 3 deri në 60 sekonda. Tek Rregullat e Instagramit thuhet se "Ju duhet t'i keni të paktën 13 vjet që të përdorni Instagramin".

Figura 1.  
Profili yt në Instagram



## RREGULLIMI I PRIVATËSISË

Ashtu si në Facebook, edhe në Instagram është e preferueshme që ta bëni profilin privat, ashtu që vetëm ndjekësit tuaj të mund t'i shohin postimet e juaja, e jo njerëzit e tjerë që ju nuk i njihni. Në këtë mënyrë zvogëlohet dukshëm mundësia e keqpërdorimit të informatave dhe postimeve tuaja, pasi ato nuk shihen nga çdokush. Për ta bërë profilin privat, shkoni tek profili i juaj, zgjedhni butonin në anën e djathtë lart , pastaj poshtë "Parametrat" (ang. Settings), , tek dritarja "Options" zgjidhni opsionin "Account Privacy" dhe lëvizni butonin në anën e djathtë. Vetëm ndjekësit/followers mund t'i shohin postimet tuaja, pëlqimet dhe komentet dhe askush nuk mund të ju ndjekë/follow pa pëlqimin tuaj.

Figura 2.  
Opsionet e llogarisë





Figura 3.  
Privatësia e llogarisë





## SI TË RAPORTONI PËRMBAJTJET E PAPËRSHTATSHME?

Në rast se dëshironi të raportoni një postim të papërshtatshëm, ju mund ta bëni këtë në mënyrë anonime duke përcjellur hapat si vijon:



### RAPORTIMI I NJË FOTOGRAFIE

**Hapi i parë:** Tek fotografia klikoni butonin me tri pika në anën e djathtë: Figura 4.

**Hapi i tretë:** Klikoni arsyen se pse e raportoni këtë postim: Figura 5.


**Hapi i dytë:**  
Klikoni "Report"; (Figura 4.)

**Hapi i tretë:**  
Klikoni arsyen se pse e raportoni këtë postim: Figura 5.



Kjo foto është spam. (It's spam)  
Kjo foto është e papërshtatshme.  
(It's inappropriate)

Figura 6. Raportimi për postimin e papërshtatshëm



### Nëse e zgjidhni opcionin "It's inappropriate" – regjoni arsyen se pse e raportoni këtë postim:

- Nuk më pëlqen. (I just don't like it)
- Foto lakuriqe apo pornografi. (Nudity or pornography)
- Gjuhë urrejtëse apo simbole urrejtëse. (Hate speech or symbols)
- Dhunë apo kërcënim për dhunë. (Violence or threat of violence)
- Shitje apo promovim i armëve të zjarrit. (Sale or promotion of firearms)
- Shitje apo promovim i drogave. (Sale or promotion of drugs)
- Ngacim apo bulizëm. (Harassment or bullying)
- Thyerje e të drejtave intelektuale. (Intellectual property violation)
- Vetë-lëndim. (Self-injury)

## SI TË BLOKONI DIKË QË JU BEZDISË? SI TË EKSPLORONI INSTAGRAMIN?

Në rast se dëshironi të bllokoni dikë që të mos ketë qasje në profilin tuaj, atëherë shkoni tek profili i personit, klikoni butonin me tri pika në anën e djathtë, zgjidhni "Block" dhe prapë "Block". Në momentin që ju bllokoni dikë, ai person nuk mund të ketë qasje në profilin tuaj, por mund të shohë komentet apo pëlqimet që i keni bërë një shoku të përbashkët në Instagram. Instagrami nuk do t'i tregoj personit që ju e keni bllokuar atë.

Figura 7. Faqja eksploruese



Eksplorimi i fotografive dhe videove në Instagram mund të bëhet përmes faqes Eksploruese, ku mund të shihni fotografi të vendeve të botës, të ushqimeve të ndryshme, faqe të revistave dhe gjëra tjera interesante. Poashtu, në këtë faqe mund të shihni fotografi të artistëve dhe njerëzve të famshëm që e shfrytëzojnë Instagramin për qëllime të publicitetit.

Në këtë faqe nuk shfaqen fotografitë tuaja nëse e keni rregulluar privatësinë ashtu që të mos e shohin njerëzit e tjerë që s'janë të njohurit tuaj.

Për më shumë këshilla, informacione, dhe rregulla më të hollësishme rreth Instagramit, ju mund të klikoni në faqen: <https://help.instagram.com/>

## SI TË JENI MË TË SIGURT NË INSTAGRAM?

Mbrojtja më e mirë në Instagram është rritja e vetëdijësisimit dhe mbajtja e llogarisë private. Duke e mbajtur llogarinë private do të keni mundësinë të vendosni se kush mund t'ju ndjekë në Instagram dhe kush do të ketë qasje në postimet tuaja.

Për të qenë të sigurt në Instagram duhet të dini këto rregulla të privatësisë:

- Mendoni për një fjalëkalim të sigurt, të cilin do të ishte e vështirë ta dinë të tjerët. Fjalëkalimin mund ta ndani me prindërit tuaj, por asesi me shokët apo shoqet e tuaja.
- Mbajeni profilin privat ashtu që fotografitë e juaja të mos mund të shihen nga çdokush;
- Vendosni duke u konsultuar me prindërit se cila fotografi mund të jetë më e përshtatshme për profil, meqenëse kjo foto mund të shihet nga çdokush edhe nëse e keni profilin privat;
- Mos pranoni ndjekës/followers të cilët nuk i njihni;
- Për shkak të rreziqeve potenciale të shumta, preferohet që mos të tregoni lokacionin në fotot apo videot e juaja;
- Nëse jeni nën moshën 13 vjeç dhe keni llogari personale në Instagram atëherë ju duhet ta mbyllni Instagramin sepse ende nuk ju lejohet ta përdorni;

# SNAPCHAT

Në hulumtimin "SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET" i realizuar nga Qendra për Studime të Avancuara FIT dhe Save the Children në vitin 2016 thuhet se 51% e fëmijëve Kosovar përdorin rrjetin social Snapchat. Snapchat njihet si rrjet social i cili gjatë viteve të fundit ka ndryshuar rrënjësisht, duke ndryshuar kështu edhe parametrat e privatësisë. Në vijim ju mund të ndjekni hapat se si të rregulloni parametrat e privatësisë në Snapchat.

## Sigurohuni që vetëm shokët tuaj të mund të ju kontaktojnë.

Parametri i parë që ju duhet të rregulloni është se kush mund të ju kontaktoj juve në Snapchat. Është e domosdoshme që në profilin tuaj në Snapchat të mund të ju kontaktojnë vetëm miqtë tuaj, dhe profili juaj të mos jetë i qasshëm për të gjithë.

Si hap i parë ju duhet të zgjedhni opsionin "Parametrat" (ang. Settings), duke vazhduar tek "Kush mund të më kontaktoj mua?" (ang. who can contact me), dhe duke zgjedhur opsionin "Miqtë e mi" (ang. My friends). Duke ndjekur hapat e rekomanduar, ju siguroheni se mund të kontaktoheni vetëm nga miqtë tuaj por jo edhe nga personat e tjerë.

## Sigurohuni që vetëm miqtë tuaj të mund të shohin storjet tuaja

Kur ju postoni një storje në Snapchatin tuaj, ajo do të jetë e qasshme për 24 orët e rradhës. Sidoqoftë, ju duhet të siguroheni që kur të postoni në storjen tuaj, ajo të jetë e qasshme vetëm nga miqtë tuaj.

Si hap i parë ju duhet të zgjedhni opsionin "Parametrat" (ang. Settings), duke vazhduar tek "Kush mund të shoh storjet e mia?" (ang. Who can view my story?) dhe të zgjedhni opsionin "Miqtë e mi" (ang. My friends). Duke ndjekur këta hapa të cilët janë të ilustruar në foton më lartë, ju siguroheni që të gjitha postimet tuaja të jenë të sigurta dhe të ndahen vetëm me miqtë me të cilët ju njihni por jo me persona të panjohur.

Figura 1. Kush mund të ju kontaktoj





Figura 2. Kush mund të shoh storjet e juaja



### Largojeni profilin tuaj nga seksioni "Shto Shpejtë" (ang. Quick Add).

Snapchat së fundmi prezantoi tiparin e ri të quajtur "Shto Shpejtë" (ang. Quick Add), i cili shfaqet në fund listën tuaj për shtimin e shokëve. Ky opsion përfshin një listë e cila ju sugjeron miq të ri në Snapchat, të cilët rekomandohen në bazë të miqësive të përbashkëta. Sa më shumë miq që keni në Snapchat, aq më e madhe është mundësia që profili juaj të shfaqet për "Shtim të Shpejtë" tek profilet e të tjerëve.

Për të evituar këto situata, ju duhet që të përcjellni hapat sikur në foton mëlartë, duke filluar tek "parametrat", duke vazhduar tek "Kush mund të më shoh në shtimin e shpejtë" (ang. Who can see me in Quick Add), dhe duke e deaktivizuar këtë opsion.

Figura 3. Seksioni "shto shpejt"





Figura 4. Njoftim për screenshot

### Kushtojini vëmendje "Screenshot-ëve"

Në krahasim me rrjetet e tjera sociale sikur Facebook dhe Instagram, sa herë që ju i dërgoni miqëve tuaj fotografi/mesazh, në rast se ata vendosin të bëjnë "screenshot" ju do të njoftoheni për këtë gjë. Kushdo që ju bën "screenshot" mund ta postojë atë kudo në internet ose të ja tregojë atë kujt do që dëshiron. Për këtë arsye ju duhet të jeni të kujdesshëm se çfarë përmbajtje jeni duke ndarë me të tjerët, mirëpo, poashtu duhet të ju kushtoni vëmendje "screenshot-ëve" nga miqtë tuaj.



Për ta bërë këtë, ju duhet që tek "parametrat" (ang. Settings) të telefonit tuaj, të vazhdoni tek pjesa "njoftimet" (ang. Notifications), dhe të aktivizoni butonin e gjelbër si në foton mëlart. Në këtë mënyrë, sa herë që dikush ju bën "screenshot" ju do të njoftoheni automatikisht.




### Mos merrni parasysh (ang. Ignore) ose bllokoni profilet e panjohura që ju dërgojnë kërkesa për miqësi

Nuk është e pazakontë të përjetoni raste kur profilet të panjohura ju dërgojnë kërkesë për miqësi, pavarësisht se ju nuk keni ide se kush janë ata, apo se si ata ju kanë gjetur juve.

Në këto raste, ju vetëm ndjekni hapat sikur në foton më lartë, ku ju shkoni tek seksioni “shto” (ang. Add), vazhdoni duke klikuar tek emri i personit i cili ju ka dërguar kërkesa për miqësi, klikoni tek “parametrat” (ang. Settings), dhe zgjedhni njërin nga opsionet “mos merr parasysh” (ang. Ignore), apo “bllokoje” (ang. Block).

Figura 5. Injorimi /bllokimi i personave të panjohur



### Mos e ndani emrin e profilit tuaj të Snapchat në rrjetet tjera sociale apo në forume online

Shumë përdorues të Snapchat shfrytëzojnë rrjetet tjera sociale si Facebook, Instagram, Twitter etj.për të shpërndarë emrin e profilit të tyre në Snapchat për të inkurajuar të tjerët që të ju dërgojnë kërkesa për miqësi në Snapchat. Ne ju rekomandojmë që profilin tuaj në Snapchat ta ndani vetëm me miqtë tuaj, dhe ta mbani sa më privat duke evituar në këtë mënyrë kërkesat për miqësi nga persona të panjohur.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

004-053.2(036)

Zymeri, Teuta

Udhëzues i detajuar për fëmijë për rrjetet sociale / Teuta Zymeri, Liridon Latifi, Anil Gashi. – Prishtinë : Qendra për Studime të Avancuara FIT, 2018. – 15 f. : ilustr. ; 21 cm.


1.Latifi, Liridon 2. Gashi, Anil

ISBN 978-9951-691-02-4

ISBN 978-9951-691-02-4



9 789951 691024



## BRICK2

BRICK2 është program i themeluar dhe implementuar nga CDF në partneritet me Qendrën për studime të avancuara FIT

## Qendra për studime të avancuara FIT

Adresa: Rruga Eqrem Çabej, nr 166,  
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

E-mail: [info@fit-ks.org](mailto:info@fit-ks.org)  
[www.fit-ks.org](http://www.fit-ks.org)  
[www.internetisigurte.org](http://www.internetisigurte.org)